

ODISE KOTE
ZONJËZA ME PIRPIRI
ROMAN

BOTIMET TOENA

ODISE KOTE

ZONJËZA ME PIRPIRI

roman

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Eris Rusi

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960399

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Mërzitja e madhe filloi të martën e tretë të prillit, në motin njëmijë e nëntëqind e ..., rreth orës 11 e 17 minuta. Ndjeu përskuqe të lëkurës në fytyrë, deri në rrëzë të veshëve. Më pas pështjellim e dhembje të lehtë koke. Goditje. Sikur po i merreshin mendtë. Gjendej në bibliotekën e zonës Bloomsbury, në një nga sallat e Muzeut të Historisë, kur vërejti diçka që i sëmboi në gjoks. E ligështoi. Një histori personale e turbulloi keqas, duke vërshuar dalldi në damarët e gjakut. Ndjeu sikur trupi kishte marrë zjarr. Kërkoi drejtorin e përgjithshëm. I thanë se drejtori i përgjithshëm, Roxher Sterling vinte vetëm ditën e hënë dhe të premte. Ku shkonte ai ditët e tjera? Mos vallë thërrmon limontinë e zyrtësinë, plot heshtje e vanitet me aventura të fshehta marroke? Apo shkon në ndonjë klub golfi? Do ta takoj të premten, mendoi, dhe do ta sqaroj përfundimisht keqkuptimin. Vetëm mos qoftë...

KAPITULLI I

Shikojeni këtë grua!

Është e premtë dhe ajo ecën përpara, guximshëm në frikën e saj. Krenarisht mban mbi supe shtatëdhjetë vite. E hijshme, me qafë gjirafe, e dijshe, udhëtare, e ndjeshme, me veshje të çuditshme. Çdo hap e hedh me sensualitet të vetëdijshe. Ngjan si uji për shkretëtirën: djeg veten që tjetri të mos ftohet. E di mirë që njerëzit janë të sjellshëm. Nuk thonë gjithnjë të vërtetën. Pëlqejnë gjërat e lehta. Kalimtare. S’duan të lëndohen. Ku është vija ndarëse midis reales dhe trillimit? Ja, kështu ishte drejtori, një tuhaf i vërtetë në dukje. Ngjasonte si ata djemtë e pazotë që flasin vetëm me mamatë e tyre. Fjalët e tij, në takimin e së premtes, më shumë e ngatërruan se sa i dhanë përgjigje përskuqjes së saj. Ja se çfarë tha drejtori: gjërat e kësaj bote nuk janë sqaruar kurrë plotësisht! Si një fotografi e varur në mur që rrëfen atë që rri fshehur brenda saj. Kjo ishte si ta çoje tjetrin në territore të askundit. Ose t’i dhuroje një papirus personit të gabuar. “Piktura apo maska?” - ku me keqardhje pikasi se trillimi në

sytë e tij gjente prehje. Iku se drejtori paskësh qenë fiks njeriu i proverbit: kur bletët e braktisin me kohë kosheren, d.m.th kokën e tij tullace, mendtë fluturojnë në drejtim të paditur. Përplasi lehtë derën pa thënë asgjë (e di mirë se fërkimi e mposht përkrahjen) duke menduar se perlat që dalin nga guaskat, ashtu si ngjarjet, faktet, të vërtetat, idetë, rrjedhin nga librat. Drita e tyre përhapet gjithkund, edhe sikur mos t'i shohin.

Kujdes me të!

Doli pas dy orësh kërkimi nga Biblioteka e zonës *Bloomsbury*, një ndërtesë monumentale, mrekulli arkitektonike e Londrës së re dhe ndjeu mbi supe se tërhiqte ende si me magnet shikime tinëzare.

Çfarë bëri atje?

Kureshtia vrau dhe macen. Por duhet guxim që ta vrasësh. Dijeni, në Bibliotekën Britanike hyhet me kartelë, nëse dëshiron të gjurmosh më shume se një milion tituj librash. Aty gjen dorëshkrime që nuk i ke parë më parë, si dhe inkunabulë që i lënë studiuesit pa fjalë. Me pak durim do të biesh në gjurmët e kopjeve të *Magna Carta*, Biblës së Gutenbergut dhe sikur të mos mjaftonte kjo do të gjesh të famshmen “Biblioteka George III”, i njëjti, i shpërndarë në gjashtë kate të ndërtesës, në të cilin mund të shohësh një koleksion librash që përfshin 150 milionë artikuj,

në pothuaj të gjitha gjuhët; dorëshkrime, harta, gazeta dhe gjithashtu të gjithë librat e shtypur në Mbretërinë e Bashkuar. Një dhuratë mbështjellë me ëndrra. Po ajo kërkon diçka tjetër. Tjetër. Nuk është nga ato që u kalon rastësive përciptas. Aty ajo shpall harkun e fisnikërisë së saj. Gjen liqenin e thellë ujëfreskët. Ulet në orën dhjetë dhe del rreth orës katër pasdite. I pëlqen të mësojë më shumë rreth strukturës, misionit të bibliotekave. Ato janë kujtesa e botës. Librat janë çudibërës, të sinqertë, të pafjalë. Ato të ndihmojnë të thyesh rregullat. Si? Po, po të thyesh rregullat. A nuk mori formë bota jonë nga thyerja e rregullave? Kishte kohë që iu besonte rregullave të thyera. Asgjë e kësaj bote nuk u zbulua paqësisht, as Amerika, as universi, as nano-lënda, as graviteti, as pulsi i yjeve të largëta, as vija e lakuar e arkitektit Gaudi në Barcelonë. Njeriu eci shpejt, këmbëzbathur përgjatë boshtit të dyshimit dhe dituria e imagjinatës triumfoi mbi rregullin. Planet e kërkimit janë pafund e paanë, kur flasin engjëj terri me engjëj drite. A ka një hartë ku shterohet e gjithë fantazia? Ka kohë që beson tek rregullat e thyera, mendja e njeriut, ekuacioni: kaos në kërkimin e përhershëm, mjegull dhe në konturet e majave të kthjellëta... Qëndron pranë dritares, në mes të rreshtit të parë dhe ashtu e pafjalë, e pazhurmë, me atë shikimin zhbirues, të pavërejtur askund, ngjan me një statujë antike.

Çfarë është në të vërtetë kjo zonjë?

Shpesh shfaqet si adoleshente, hormon në lëvizje. I shijon ritmi. Tregimin e librit e rrëmben kur lexon në fillim faqen e fundit. Kështu bënte dhe kur ishte e vogël. Pastaj i rikthehet librit nga fillimi.

Po historia e saj?

Ajo beson tek ideja e beftë si fatsjellëse e një zbulimi. Por e di mirë që ideja e beftë nuk e zëvendëson punën, ashtu si puna nuk e zëvendëson as e detyron idenë e beftë të vijë, kur do ajo. Puna dhe pasioni kur janë bashkë, arrijnë ta ndjellin idenë e beftë. Ideja e beftë kurrë nuk do të shfaqej nëse njeriu nuk do të kishte pas vetes ato orë mundimi në bibliotekë, në tryezën e punës, atë shqetësim të vazhdueshëm për çështjet e mbetura hapur. Ajo e ka mirë parasysh edhe situatën, kur pavarësisht përpjekjeve, frymëzimi mund të vijë ose të mos vijë fare. Ka mësuar herët se të vdekurit, ata që i kanë mbaruar punët, janë më me fat. Ata jetuan, por brenda tyre tani s'ka mbetur asgjë.

Është më e lehtë të ikësh apo jo?

Si doni t'ju perceptojë historia - ngjan se pyet pa zë lexuesit e munguar të sallës? Të rinj dhe të bukur?

Epo ejani në Bibliotekë!

Depoja e studimeve është vërtet mjaft e pasur. Sidomos me mitet. Janë mitet lashtohelene, natyrisht, por edhe proza nordike dhe edat poetike. Ezopi,

Homeri, Unaza e Nibelungut, legjendat kelte dhe tri Tekstet e mëdha të Europës: Tekstet e Francës, grupi i tregimeve rreth Karlit të Madh; Tekstet e Romës, që lidhen me atë perandori; dhe Tekstet e Britanisë, legjendat rreth mbretit Artur. Në Gjermani, janë përrallat e mbledhura nga Jacob dhe Wilhelm Grimm. Maturia vjen nga leximet e kujtimet. Versione të së njëjtës ide. Është natyrë e butë, por për librat s'lëshon pe. “Janë miq të vyer, - thotë shpesh, - ndaj gëzoju miqve të vjetër, si ditës me diell në dimër.” Ajo lëviz prej leximeve, pasi ka lënë pas shpine kërshtërinë e pangopur dhe dyert e mëdha të drurit me zbukurime e gdhendje që të marrin mendtë.

Po ajo piktura e madhe në holl që e mahnit, çfarë mëton sa herë e sheh?

Ajo ballorja, ajo që tregon se njeriu në bibliotekë ka hequr lëkurën e tij për ta hedhur mbi shpatulla si pardesy. Ajo pse nuk ka fytyrë? Si pikturë shiu në xham. Mos është pikturuar me fjalë si një portret dëshire? Nuk mund të jetë portret mëshire. Dashuria ka kohën e vet, por dhe urrejtja ka kohën e vet. Apo është fantazmë? *Nuk shikoj fantazmën, por njeriun, bërtiti krejt qenia e saj, teksa la shkallaren sipërore për të dalë jashtë.*

Doli.

Ngjau sikur iu hapën krahët. Dhe ishte brilante, sovrane, madhështore, gati të fluturonte. Si një pulëbardhë

që nuk fsheh asnjë mister, e lirë dhe ende kureshtare. Zbriti shkallinave të mermerta, ku një mjegull e dendur, sfilitëse, nga ato që të marrin frymën, nderej mbi rrugët, godinat e qiellgërvishtësve të Londrës. Sa shi paskësh rënë gjatë ditës? Era hollake, cinike si nënqeshja e zonjës, lëvizte si të ishte një shpirt që nuk prehej. Asnjëherë nuk e paskemi fshehur dot harenë e kalimit nga dija në mjegull dhe anasjelltas. Një zhvendosje e përhershme e vëmendjes e shoqëronte, ndërsa i pëlqente shumë fakti se në Londër fliten mbi treqind gjuhë të botës. Ndihej sikur ecte në një rrugë të pasigurt. Përse hobi dhe pasioni për bibliotekat kishte përzgjedhur pikërisht atë? Në çantën e saj nuk ka thjesht disa foto, një parfum, apo buzëkuq, por sigurisht aty gjendej Ipad për shënimet dhe idetë e lindura gjatë lexim - kërkimit.

Ky është shekulli ku fshehja është e pamundur. Pesë ditë më parë, hyri në Muzeun e Historisë Natyrore dhe në një prej ekspozimeve u ndje e përhumur. Bosh. Si t'i kishin dhënë një libër të keq nga që s'e pëlqenin. Pështjellimi ishte i menjëhershëm. Përskuqja gjithashtu. Muzeu është përherë një festë madhështore e botës natyrore, vendosur në zemër të Kensingtonit të Jugut, në Londër. I ndërtuar në një

ndërtesë mahnitëse, e stilit gotiko-roman, “Gothic revival dhe Romanesque revival”, me tavane të larta dhe linja të inspiruara nga katedralet gotike mesjetare romane me salla madhështore e detaje të ndërlikuara arkitekture, muzeu është nga institucionet kryesore shkencore në botë. Ai nuk është vetëm një depo e objekteve dhe ekzemplarëve të jashtëzakonshëm, por edhe një qendër e gjallë për kërkime, edukim dhe zbulim. Siç ia donte zakoni, u ndal në një prej ekspozitave dhe mbeti shtang kur pa veten si në pasqyrë: përballë saj u shfaq manekinia me kostum e kapelë me piripiri. Fërkoj sytë e bërë mjegull. Jo çdo mjegull e butë është një portë për në parajsë. Shënimi poshtë manekines: “Veshje antike nga Ballkani”. U tremb. Nuk besoi se ishte shkruar vërtet ashtu. U ul në shesh përballë saj dhe nuk ia ndante sytë. Nuk mbante mend se sa qëndroi e ngrirë. Mendimet i ishin bërë lëmsh. Tiliksur si valë të ngecura nëpër shpella. “Veshje antike Ballkani...??? Hëm...!” - për atë veshje që iu duk tepër e njohur. “Mund të jetë e tij”, - i vetëtiu në tru dhe ndjeu sikur gjunjët iu prenë e ra në tokë. Por jo. E mbajti veten. “Duket që sapo e kanë vendosur. E pakuptimtë. Krejt e pasaktë.” Në të vërtetë pezmi, ndjenja e hidhur e manipulimit, më saktë, trazimi për “pasaktësinë qëllimore” duhet të ketë nisur pikërisht nga emërtime të tilla. Të përgjithshme. Të askujt.

Trazimi duhet të jetë tepër i motshëm. Ka gjasë të jetë po aq i vjetër sa zbulimi i seksit, i tmerit ose i vdekjes. Ajo kishte një veshje të tillë, pirpiri quhej, që e ruante si gjënë më të shtrenjtë të jetës. Mund ta dëshmonte origjinën. Për herë e kishte veshur në një takim ekspertësh në Bibliotekën “Admont Abbey” të Austrisë. “Admont Abbey” është nga ato bibliotekat magjepsëse që i çojnë gjërat në nivelin tjetër me brendësinë e tyre. Këto janë llojet e bibliotekave që veprojnë si faltore për fjalën e shkruar, pavarësisht nëse janë të zhytur në shekuj të historisë ose janë buza e modelit modern. Biblioteka “Admont Abbey” në Austri, është plot me afreske të holla të vendosura brenda arkitekturës baroke, zbukuruar me ngjyrë ari dhe të bardhë, dhe daton që nga viti 1776. “Admont Abbey” mban titullin e bibliotekës më të madhe të manastirit në botë, që përmban rreth 70 mijë vëllime, si dhe serinë e afreskeve nga Bartolomeo Altomonte që mbulon secilën nga shtatë kupat e bibliotekës. Sa shkonte veshja e saj e çuditshme, veshja me Pirpiri me atë ambient?! Sytë e të gjithëve ishin ngulur mbi të, tërhequr si prej një magneti të fuqishëm dhe Rita Blomberg që i tha në vesh: Nuk kam parë për ty vëmendje më të madhe se sa kjo e sotmja! Mrekulli!

“Veshje antike nga Ballkani kjo ë...? Do ta shohim!”

Cilësimi iu duk si psalm i Shën Judës, atij shenjtorit të kauzave të humbura. I ngjau si një e prerë thike që lëvizte tinëzisht mespërmes gjireve. “Mos e bëj dramë! - i tha vetes. - Dramat janë për budallaqet e plakura.” Njëherë besoi te pakujdesia spontane, mungesa e njohurive, mosnjohja e kufijve, apo thjesht neglizhenca, gabimi njerëzor. Kuratorit ndoshta i kishte shpëtuar detaji i autenticitetit të objektit ose thjesht hartuesi i teksteve të legendave kishte harruar ta shënonte.

“Apo mos ndoshta është mbulim i qëllimshëm, fshehje e origjinës, megjullim i saj? Mos ndoshta, ashtu si në baladat ballkanike me përngjasimet e motërzimet e shumta, kokëfortësia për të pasur të vetin variantin e parë, nistorin, variantin master, prej nga ku prodhohen dhjetëra kopje, kishte ngritur krye?

Uf... dhe ky Ballkani ç’histori e kokolepsur?

A mos vallë, si në mjaft raste të tjera, ky paskësh qenë instrumenti për të shuar grindjet, gjënimet e zhurmshme ballkanike, të gatshme për të ndezur fitila zjarri?”

Ajo e di mirë se jeton në një kohë të trazuar, kohë që nuk mendon, kohë kur liria - dhe sidomos ajo e shprehjes, pa të cilën bota e librave nuk mund të ekzistojë - është kudo nën goditjen e autoritarëve, populistëve, demagogëve, gjysmanalfabetëve,

narcisëve, shpërfillanëve; kur sidomos bibliotekat i nënshtrohen armiqësisë dhe censurës; kur fetë ekstremiste dhe ideologjitë fanatike kanë filluar të ndërhyjnë në fusha të jetës ku ato nuk bëjnë pjesë. “Ndaj s’ka rëndësi ajo që bën në një ditë të mbrame kur punët ikin fjollë, rëndësi ka ajo që bën në një ditë të keqe, ditë kur ngatërrestarët e shpërfillanët i vënë zjarrin botës. *Me se?* - i tha vetes. Me gënjeshtër, manipulim.

Ki mendjen!

Sukses është aftësia për të përballuar dështimet me entuziazëm. Ajo e dinte mirë që e vërteta gjendet gjithmonë tjetërkund. Befas, sikur iu kujtua Sokrati i antikitetit, që dikur kishte thënë: “Nëse një gomar do të më godiste, a do ta padisja atë?” “Joooo...! Nuk ka të bëjë me fitimin e çdo argumenti, - kishte shpjeguar më pas Sokrati, - por me zgjedhjen se cilat argumente meritojnë energjinë tonë.”

Injoranca bërtet, mençuria hesht, qetësoi disi veten. Inteligjenca e vërtetë nuk ka nevojë të mburret, thjesht shkëlqen. Këto fjalë të arta e çuan befas në toka të largëta. Një vështrim i mendjes në sytë e dikujt që ishte diku larg, mjaftoi për të ndezur qiejt. Në vend të shqetësimit, trupi i saj nuk ndjeu rebelim, por prehje të ëmbël. “Eja, - sikur i thirri, - eja. Eja më shpëto! Le të ndërrojmë rolet. Ti, edhe sikur në varr

të jesh duhet të ngrihesh dhe të vish këtu në Londër. Jam m'u përballë eksponatit ku Pirpiria paraqitet gjasme si veshje Ballkani dhe jo shqiptare. Eja tani këtu me mua se nuk ndihem mirë. Eja, ashtu si unë dikur... dikur, kur erdha tek ti. Eja! Jashtë ka rënë muzg. Terr. Po unë dhe ti mund të ndezim një zjarr në rrugë. Zjarr për të ngrohur ndjenjën e lënë përgjysmë, në harresë. Mbase dhe për të dëshmuar... Ah. Kjo të duket një shkëndijëz me ëndrra të pamundura? Vendimet e zgjuara vijnë nga përvoja dhe përvojat dalin nga gabimet. Ti mund... Mund të vish? Si thua? I dëgjon trenat që vijnë dhe ikin. Nuk i dëgjon? Londra mund të shkëlqejë këtë natë. Nuk ka rëndësi ku duam të shkojmë. Ti vetëm eja! - dhe u mbush me një përkorje, hov të freskët lumturie. - Nuk e di a është ky ritmi i zakonshëm apo diçka të ka ndodhur? Eja dhe kërcejmë. Nëse kërcejmë, e çojmë ritmin në qiell. Po erdhe sonte e di që do të ndihem shumë mirë...”

Pas shqyrtimit të vështirë, duke cytur habinë e parë nga fjalja që rrinte gozhdë në tru “veshje antike nga Ballkani” ditë më vonë, mbi trapezin e ngrënies në kuzhinë do të linte shënimin: “Nisem në Korfuz.

Jam në konferencë ndërkombëtare mbi diversitetin e kulturës të librit dhe rrezatimin në jetën komunitare. Ju telefonoj kur të mbërrij...” Instinkti është art pa qëllim, ekstatë që buron, ndonëse dukuri e pashpjegueshme, mbetet fenomen i brendshëm dritësor i soditjes së mençur. “Ju telefonoj sa të mbërrij ...” - shënim që e la pa u menduar gjatë, njësoj si atëherë kur ishte tetë vjeçe dhe braktisi mësimet e pianos. Nëna i shkuli fort veshin, por ajo nuk qau. Zemërimi zgjati për shumë kohë. Nuk e preku pianon me dorë. Ruante inatin dhe një sekret; flirtin e së ëmës Martha, me profesorin që jepte mësimet e pianos. Gjithë skenën e kishte parë nga vrima e çelësit. Flirti dhe fëmijëria e saj fërgëlluan dhe njëherë fort, hodhën hijen e tyre në mbretërinë e dritës, përshkruan tangjent në cepin e trurit vizatimin e gjurmës së kujtesës, aty në engramën gjithë vija e shenja të pazbërthyeshme. A nuk ishte vallë ajo ndjenjë e përzier zemërimi, hutimi, zilie, mospranimi diç e ngjashme me humbjen e takimit të parë? Shkrimi në shënim dallohej qartazi që ishte shkruar me dorë të dridhur. Këtu fillon enigma, si një rebus, për Çarlsin - bashkëshortin, dhe Nikun, djalin. Çarlsi mbeti turivarur nga shënimi, ndërsa Niku as që e çau kokën. Koka e tij ishte mbushur me plane për aventurat e udhëtimeve në malet e botës. “Ëndërrrojmë për udhëtimet po a nuk është brenda nesh gjithësia? -

u rrek të qetësonte Çarlsin. - Thellësinë e shpirtit tonë ne as që e marrim dot me mend. Apo jo? Brenda nesh kalon rruga misterioze e dashurisë, - sepse deshi t'i pëshpëritë ato fjalë duke përkëdhelur gjoksin leshtor të tij. Kur të kthehem, të jap fjalën do të të rrëfej gjithë aventurën,” - nuk thoshte kurrë një fjali pa pasur diçka tjetër në mendje. I foli me gjuhë falltareje. Çarlisi për habi, nuk mundi të shestojë veçmas asnjë nga fjalët e saj. Pas disa sekondash e zuri gjumi. Gjumë i qetë. Nuk kishte ndjerë as zhurmën më të vogël kur ajo kishte ikur nga shtëpia. Asaj nate kishte fjetur top. Si asnjëherë tjetër. Në mend i ishte sjellë humori fin i sër Jared Harris mbi tregun e tronditur të naftës. “Para hapjes së bursës e rënies së kampanës çmimi ra në 8 dollarë për fuçi. Pas mbylljes, kur ra përsëri kambana, çmimi shkoi në 10 dollarë për fuçi.

- Kush punon para hapjes e mbylljes së bursave?
- kishte pyetur në gjendje habitore Kris Smith, një rishtar burse nga Mançesteri.

- Pronarët e kampanave, - kishte pëshpëritur nëpër dhëmbë sër Jared Harris, dhe e qeshura ishte përhapur valë - valë nëpër ekrane dhe në sallën e ngrohtë mondane.”

Çarlisi qëndronte në krah të sër Jared dhe i ngjante se diç nga mençuria e tij përcillej edhe tek ai. Karakteri i tij thellësisht utopik, fokusuar vetëm mbi

çështjet e parasë (tek paraja ose askund tjetër ishte për të amshimi mbi botën), e bënte të kishte paqartësi në njohjen e “lidhjeve të rrezikshme”, labirinteve të ndjenjave e të zemrës. Dikur, në një nga ato mbrëmjet e ngrohta familjare, ulur në kanapenë e ballkonit që shikonte matanë urës së zgjatur mbi lumin Thames, midis Qytetit të Londrës dhe Southwark, në Londrën qendrore, ajo tentoi t’i fliste mbi ndjenjat dhe pasionet. Por Çarlsi as që e kishte mendjen aty. Madje iu dukën marrëzi ato ide e mendime, të shqiptuara sipas tij, krejt pa vend. Nuk e kuptonte që gruaja e tij ishte ato çaste dhe qiell, dhe tejqyrë, dhe yll i palëvizshëm. As kur ajo i tha se ura e Londrës ku mbante të ngulura sytë, ishte përshkruar në format e saj të ndryshme, në art, letërsi dhe këngë, përfshirë rimën e çerdheve “London Bridge Is Falling Down”, dhe poezinë “The Waste Land” nga T.S. Eliot. Ajo ishte një urë e vjetër që datonte me shekullin e 9-të para Krishtit dhe ishte ndërtuar pesë herë. Shpesh ajo kalonte orë të tëra mbi atë urë, më saktë me sytë vendosur në teleskopin që gjendej aty, në kërkim të laureshës kalandra që ishte shfaqur në lumin Thames. Ato ishin orë emocionuese sidomos kur ndeshte laureshën kalandra. I bëhej se dëgjonte këngën e saj. Njëherë tjetër ajo i tregoi atij për një shkrimtare të shekullit të kaluar, profesoreshë në Francën fqinje. Simone de Beauvoir quhej.